



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

RAPORT

MBI MBLEDHJEN E KOMISIONIT PËR POLITIKËN E JASHTME

PËR SHQYRTIMIN E

PROJEKTLIGJIT

"PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, PËR MBROJTJEN SHOQËRORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KANADASË"

I. HYRJE

Më 10 shtator 2019, Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë".

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t'u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. QËLLIMI DHE PERMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar synon realizimin e një marrëveshjeje që konsiston në ofrimin e përfitimeve në sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, trajtimin me përfitime dhe të ardhura. Gjithashtu, rregullat koordinuese garantojnë që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre e të mbijetuarit, të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar. Bashkimi i periudhave të siguruar, sipas legjislacioneve kombëtare të ndryshme, të merren në konsideratë, për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre.

Miratimi i kësaj marrëveshjeje do të krijojë mundësinë e përfitimit të pensioneve për shqiptarët që jetojnë e punojnë në Kanada, si dhe të shtetasve kanadezë të cilët vijnë për të punuar në Shqipëri, si të punësuar nga kompani investitore në industrinë nxjerrëse, minerare e energjetike, apo të vetëpunësuar. Gjithashtu, krijohen hapësira ligjore për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë, përveçse në Kanada edhe në vendet e tjera me të cilët të dyja vendet kanë marrëveshje dypalëshe.

Këtyre personave, e drejta për përfitime nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore iu lind në momentin kur ata të kenë mbushur moshën për pension. Sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të gjithë këta persona do të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore shqiptare nëse kanë mbi 15 vite pune të siguruara.

Palët kanë rënë dakord të japin përfitime në para për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore.

Nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ketë efekt financiar të menjëhershëm, pasi e drejta për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore shtetasve shqiptarë iu lind në një periudhë të dytë, kur ata të kenë mbushur moshën për pension. Duke pasur parasysh që emigrantët shqiptarë që kanë periudha sigurimi janë relativisht të rinj dhe duan të paktën 6-10 vjet për të dalë në pension, efektet financiare do të fillojnë pas kësaj periudhe. Kostot administrative për zbatimin e kësaj marrëveshjeje mbulohen nga institucionet zbatuese të secilës palë.

III. DISKUTIMI NË KOMISION

Zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Dajana Sorensen, informoi deputetët për qëllimin, vlerën dhe natyrën e marrëveshjes si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve veçanërisht për shtrirjen gjeografike të marrëveshjeve të kësaj natyre.

Relatori z. Ervin Bushati u shpreh se në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe theksoi se nevojitet që marrëveshje e tilla të arrihen edhe me vende të tjera ku ka një prani të konsiderueshme të bashkëkombësve tanë, veçanërisht me Italinë dhe Greqinë.

Znj. Vasilika Hysi dhe z. Ralf Gjoni shprehen mbështetjen dhe gatishmërinë e Komisionit për tu angazhuar me të gjitha mundësitë e tij në favor të shtrirjes sa më të gjerë të këtyre marrëveshjeve

Kryetarja e Komisionit Kodheli, pasi vlerësoi paraqitjet e bëra dhe falënderoi pjesëmarrësit për ndërhyrjet, ftoi Komisionin të votonte projekt-ligjin.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi me unanimitet projektligjin në parim, nën parim dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORI

ERVIN BUSHATI

KRYETARE

MIMI KODHELI